



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 12 prot.

Kamëz, më 26.2.2026

V E N D I M
Nr. // .Datë 26/2 2026
MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURAVE
PËRGJEGJËSE DHE PROCEDURAVE PËR MATJEN DHE RAPORTIMIN E
PERFORMANCËS NË BASHKI”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.2.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.07 Datë 23.2.2026 mbështetur në ligjin nr. 8419, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” Udhëzimit nr. 22, datë 13.07.2018; Vkm nr. 252, datë 20.04.2023 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030”; Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”; Urdhri i Kryeministrit nr. 17, datë 20.02.2023, “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës (GNP) për hartimin e propozimeve ligjore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet sistemit të matjes së performancës së shërbimeve publike; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe procedurave për matjen dhe raportimin e performancës të Bashkisë Kamëz.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Integrimit të BE-së dhe Projekteve të Huaja dhe zhvillimit ekonomik dhe të gjithë strukturat e administratës së bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

